SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA

# NE JEMI SIGAL UNIQA Group Austria

RAPORTI VJETOR 2016



# NE JEMI SIGAL UNIQA Group Austria



NE jemi kompania lider në tregun e sigurimeve në Shqipëri, ku udhëheqim tregun vendas që prej vitit 2003. Prej më shumë se 13 vitesh operojmë suksesshëm në Kosovë, ku kemi përforcuar pozitat tona vit pas viti dhe jemi një emër jo vetëm i njohur për shqiptarët tanë atje, por edhe një brand i besuar.

Grupi SIGAL UNIQA u zgjeruar në vitin 2004 edhe përtej kufijve, në Maqedoni, ku pavarësisht numrit të kompanive të sigurimeve kemi ruajtur pozitat tona dhe kemi zgjeruar rrjetin e shërbimit ndaj klientëve, sikundër kujdesemi gjithmonë për të rritur cilësinë e shërbimit.

Me rreth 30% të tregut, ne jemi kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri. Grupi SIGAL UNIQA është një familje e madhe që numëron mbi 1200 punonjës dhe agjentë, të cilët u shërbejnë 500 mijë klientëve në tre shtete: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

SIGAL UNIQA është një grup i rëndësishëm financiar, i përbërë nga 8 kompania Jetë dhe Jo-Jetë, i cili zotëron106 milionë Euro asete, numëron 57.6 milionë Euro prime të shkruara për vitin 2016, rreth 19 milionë Euro dëme të paguara ndër vite dhe një kapital prej 32 milionë Eurosh.

Volumi i primeve (Euro)

| | |
|---|---|
| Group | 58,879,000 |
| AL | 35,123,000 |
| KS | 11,263,000 |
| MK | 12,615 ,000 |

Nr. i kontratave

| | |
|---|---|
| Group | 595,815 |
| AL | 283,777 |
| KS | 79,405 |
| MK | 232,633 |

Nr. i zyrave

| | |
|---|---|
| Group | 401 |
| AL | 225 |
| KS | 65 |
| MK | 111 |

Agjentë dhe punonjës

| | |
|---|---|
| Group | 1139 |
| AL | 605 |
| KS | 176 |
| MK | 358 |




15 Sponsor zyrtar i Kombëtares Shqiptare të Futbollit




15 SIGAL UNIQA KOSOVA vlerësohet me Medaljen e Mirënjohjes në 13-vjetorin e saj



23 Sigurimi online-tashmë një realitet


3 **Ne jemi SIGAL UNIQA**
Te dhëna kryesore për kompaninë SIGAL UNIQA

5 **Grup rajonal sigurimesh**
Harta e shpërndarjes së kompanive

6 **Fjala e CEO-s së UNIQA**
Fjala përshëndetëse e Z. Andreas Brandstteter, CEO i UNIQA Insurance Group

8 **Fjala e CEO-s së SIGAL UNIQA**
Fjala përshëndetëse e Z. Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA Group Austria

10 **Ne jemi UNIQA**
Te dhëna kryesore për kompaninë UNIQA

12 **Vlerat dhe parimet tona**

13 **Struktura dhe askionerët e SIGAL UNIQA**

14 **Bordi mbikëqyrës i SIGAL UNIQA**

15 **Ngjarje të rëndësishme**
- Sponsor zyrtar i Kombëtares Shqiptare të Futbollit
SIGAL UNIQA KOSOVA vlerësohet me Medaljen e
- Mirënjohjes në 13-vjetorin e saj
- Takimi vjetor 2016
- Vlerësime ndërkombëtare

21 **Përgjegjësia Sociale**

23 **Sigurimi online-tashmë një realitet**

24 **Tregu i sigurimeve në rajon**

26 **Të dhëna financiare**

28 **Raporti i pavarur i auditit**

35 **Raporti i auditit të brendshëm**

38 **Parimet e vlerësimit dhe monitorimit të rrezikut**

42 **Objektivat 2017**


# GRUP RAJONAL SIGURIMESH




- Europa Qendrore (CE)
- Europa Lindore (EE)
- Europa Juglindore (SEE)
- Rusia

Nr.X Pozicioni në tregun e sigurimeve të secilit shtet.

1) Tregu i sigurimeve të jetës në Rusi.



*Andreas Brandstetter*
*CEO, UNIQA Insurance Group*
*Kryetar, Bordi Mbikëqyrës i SIGAL UNIQA*

*Të dashur aksionerë,*

Viti 2016, të cilin po ua paraqesim në këtë raport, filloi intensivisht për ju edhe për ne. Në janar ne ju njoftuam se do të bënim një ndryshim strategjik sa i përket drejtimit të fazës së tretë dhe të fundit të "UNIQA 2.0", programit tonë të gjatë strategjik.

Ky ndryshim u bë për dy arsye: E para, investimet e nevojshme prej 500 milionë euro në Teknologjinë e Informacionit, dixhitalizimin dhe inovacionin në vitet që do të vijnë, për të na ndihmuar që të jemi proaktivë për tu përballur me sfidat e moshës së internetit dhe së dyti për shkak të efektit negativ të normës së ulët të interesit së mjedisit ku operojmë, gjë e cila po shkakton uljen e të ardhurave nga investimet në kapital në përgjithësi dhe veçanërisht në sigurimet e jetës.

Fakti që në janar, falë pozicionit të fortë të kapitalit tonë, ne e konfirmuan planin tonë për të rritur dividentët për çdo vit, pavarësisht impaktit të këtyre dy komponentëve me ndikim afatshkurtër dhe afatmesëm, pavarësisht të gjithave, kjo nuk e uli shqetësimin e shumë prej aksionerëve tanë.

Ndaj, të gjithë së bashku u ulëm për të konceptuar dhe 'ndërtuar' atë që ne e quajtëm "UNIQA House– Shtëpia UNIQA", e cila përbëhet nga disa kate dhe dhoma, ku secila përfaqëson një nevojë, një ndryshim, një objektiv apo qëllim, sikundër edhe ndryshime apo përparime.

Kati i dytë i shtëpisë tonë është aty ku jetojnë inovacioni dhe dixhitalizimi, dy kryefjalët shumë të rëndësishme të së ardhmes tonë.

Në 2016 ne arritëm të gjithë në një ide dhe konkluzion të përbashkët si grup që dixhitalizimi nuk është një stuhi e përkohshme, por ai do të përcaktojë nëse një kompani në industrinë tonë do të mbijetojë apo do të vdesë.

Ajo ç'ka ne dhe shumë të tjerë në industrinë e sigurimeve nuk kanë mundur ende të bëjnë është një kapitalizim i këtij fenomeni, për ta kthyer dixhitalizimin në të ardhura dhe përfitime të parashikueshme.

Ne po mësojmë, po trajnohemi, po sjellim të "lindur dixhitalë" në skuadrën tonë, po investojmë kohë dhe para, po fillojmë të punojmë në shumë drejtime, po bashkëpunojmë me mediat sociale dhe po investojmë në zhvillimin e ideve të reja.

Një ditë kemi ide të mëdha, por ditën tjetër mund të mos i marrim parasysh. Kjo është se përse jemi akoma në pikën fillestare.

Tanimë as kompania jonë dhe as industria e sigurimeve në tërësi nuk ka patur ndonjëherë një inovacion kaq relevant dhe kaq të vërtetë në zhvillimin e saj.

Disavantazhi ynë është që duhet të jemi veçanërisht shumë të kujdesshëm me burimet e limituara që kemi, më së paku në krahasim me sfidat globale.

Avantazhi ynë është se ne mund të punojmë shumë më fort sesa konkurrentët tanë dhe sigurisht që nuk do të udhëhiqemi nga ky objektiv, sepse ne duam të fitojmë!

Ashtu si me programin tonë të investimit prej 500 milionë euro, ne gjithashtu duam ti paraprijmë përgjegjësisë sonë afatgjatë të të drejtuarit një kompanie, një kompani e cila do të mirëpresë edhe disa milionë klientë të tjerë në 18 shtete të Europës.

Kjo është baza e objektivit tonë të deklaruar për të paguar dividentët që rriten në mënyrë absolute çdo vit, jo vetëm nga brenda kompanisë tonë, por edhe në bazë të rritjes së të ardhurave dhe të rrjedhës së qëndrueshme të parasë.

Në emër të punonjësve të UNIQA-s do të doja t'ju shprehja mirënjohjen tonë të sinqertë për interesin në "UNIQA House". Edhe pse bota në të cilën shtëpia jonë qëndron është së fundmi e turbulluar dhe komplekse, ajo na jep mua dhe kolegëve të mi të Bordit Menaxhues kënaqësinë e madhe për të punuar për ju çdo ditë, me entuziazëm dhe në mënyrë konstante.

**Andreas Brandstetter**
**CEO**
**UNIQA Insurance Group**



*Avni Ponari*
*CEO*
*SIGAL UNIQA Group AUSTRIA*

## *Të dashur klientë dhe partnerë të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA,*

Viti 2016 ka qenë i mbushur me sfida, përgjegjësi, arritje si dhe përkushtim maksimal. Përkushtim për punën tonë, për punonjësit dhe kolegët më të cilët ndajmë pjesën më të madhe të kohës tonë, por, përkushtimi më i veçantë, ka qenë mbi të gjitha për klientët tanë.

Klientët janë kryefjala jonë dhe për këtë arsye e gjithë vëmendja, rritja e cilësisë së shërbimit dhe ofrimit të produkteve sipas nevojave dhe kërkesave të tyre, janë busulla që na udhëheq ne si SIGAL UNIQA në punën e përditshme.

Sfidat në industrinë e sigurimeve janë të shumta, por veçanërisht në tregun e sigurimeve në Shqipëri janë edhe më të prekshme. Industria e sigurimeve në vendin tonë mbetet kryesisht një industri e sigurimeve të detyrueshme sesa e sigurimeve vullnetare siç do duhej të ishte dhe ashtu siç është në të gjithë Europën. Edhe viti 2016 u orientua nga sigurimet e detyrueshme në tërësi, edhe pse unë jam veçanërisht i lumtur që SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është e vetmja kompani në Shqipëri, e cila krahas të qenurit lider dhe me përqindjen më të madhe të tregut, portofolin e saj e përbëjnë mbi 50% sigurimet vullnetare. Kjo na bën ne krenarë dhe të sigurtë se po udhëheqim këtë industri drejt një trendi të ri, drejt kultivimit të mentalitetit të sigurimeve si një mënyrë jetese tek qytetarët shqiptarë.

Globalizmi dhe dixhitalizimi po e orienton biznesin drejt një rryme të re, drejt shpejtësisë, thjeshtësisë dhe prakticitetit. Për këtë arsye, duke patur vizionin e qartë për nevojat dhe dëshirat e klientëve dhe duke qenë të hapur ndaj kërkesave që na dikton koha dhe tregu, skuadra e SIGAL UNIQA-s po i paraprin këtyre ndryshimeve, përmes përforcimit të dixhitalizimit dhe teknologjisë së informacionit. Në vitin 2015 ne filluam të investojmë dhe modernizojmë sistemin tonë të teknologjisë së informacionit, duke u fokusuar si në investimin në hardware ashtu edhe në afrimin pranë skuadrës tonë të të rinjve me ide, energji e qasje krejtësisht të reja.

Frytet e këtij investimi filluan të shpërfaqen që në vitin e parë të implementimit dhe përgjatë 2016-ës SIGAL UNIQA u kthye në një nga motorët e parë të kërkimit dhe ofrimit të siguracioneve online. Për herë të parë në Shqipëri klientët dhe qytetarët tanë mund të blejnë siguracionet që ju nevojiten vetëm me një klikim online nga celulari i tyre. Ky është një zhvillim tejet i rëndësishëm nisur nga fakti që jeta është bërë aq e shpejtë dhe e ngarkuar sa sot njerëzit kërkojnë të shkurtojnë sa më shumë procedurat burokratike nëpër zyra, të kursejnë kohën dhe të shkurtojnë shpenzimet.

Viti që lamë pas shënoi përvjetorin tonë të 13-të në Kosovë dhe 12-vjetorin në Maqedoni, ku i ruajtëm pozitat tona dhe me ndryshimet dhe investimet që po kryejmë synojmë që brenda një kohe të shkurtër të jemi lider edhe në tregun e sigurimeve tek shqiptarët tanë të Kosovës dhe tek shqiptarët e fqinjët tanë në Maqedoni.

Ne vazhdojmë të ruajmë pozitat tonë të liderit me 30% të tregut dhe të jemi një nga grupet financiare më të fuqishëm në rajon falë punës së palodhur të rreth 1200 punonjësve dhe agjentëve tanë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, falë besimit të paçmueshëm të qindra-mijëra klientëve tanë, si dhe falë bashkëpunimit të shkëlqyer me partnerit tonë kyç dhe të vetëm UNIQA Insurance Group. Gjigandi austriak i sigurimeve, me një histori e përvojë 200-vjeçare në industrinë e sigurimeve në Europë, është një garanci e patjetërsueshme jo vetëm për ne si SIGAL UNIQA por edhe për tregun e sigurimeve në tërësi në Shqipëri dhe rajon.

Me vizion e ide të qarta, me staf të përkushtuar, me besimin e plotë nga klientët tanë dhe me mbështetjen e fortë të partnerit tonë strategjik ne jemi të bindur për rrugën që po ndjekim, me hapa të sigurtë dhe mbi baza të shëndosha.

Duke falënderuar përzemërsisht secilin prej jush për bashkëpunimin e deritanishëm, kam bindjen se së bashku do të jemi të sigurtë drejt rrugës së përbashkët të suksesit.

**Avni PONARI**
**CEO**
**SIGAL UNIQA Group Austria**




**SIGAL pjesë e UNIQA GROUP**

Që prej vitit 2007 SIGAL është pjesë e një prej grupeve më të mëdha financiare në Austri, UNIQA Insurance Group.

UNIQA GROUP është lider në tregun e sigurimeve të Austrisë dhe të Europës Qendrore dhe asaj Lindore. Mbi 20 mijë punonjës iu shërbejnë mbi 10 milionë klientëve në 19 shtete, nga të cilat 15 shtete të Europës Qendrore-Lindore. Gjigandi austriak i sigurimeve, me një histori mbi 200-vjeçare në tregun e sigurimeve, zotëron mbi 33 miliardë Euro asete dhe mbi 7 miliardë euro prime në vit.

Me 21% të tregut, UNIQA është është kompania e dytë më e madhe në Austri. Aktiviteti i grupit UNIQA është i shtrirë në 19 shtete të Europës Jug-Lindore, ku në pjesën më të madhe kompanitë UNIQA janë lidere të tregut.

Në vitin 2016, UNIQA Group lançoi programin më sfidues të të gjithë këtyre dekadave, porgram i quajtur “UNIQA 2.0”, i cili konsiston në inevstimin e 500 milionë eurove, në mënyrë që proceset dhe produktet e kompanisë të riorientohen sipas nevojave dhe pritshmërive të klientëve, duke patur si busull orientuese transformimin dixhital të kompanisë.

UNIQA GROUP hyri në tregun shqiptar të sigurimeve në vitin 2007, nëpërmjet bashkëpunimit me kompaninë më të madhe në vend, SIGAL, duke u bërë kështu i pari investitor i huaj që futej në industrinë e sigurimeve në Shqipëri.






# VLERAT DHE PARIMET TONA




## Ne frymëzojmë

Ne jemi të përkushtuar ndaj klientëve dhe partnerëve tanë. Ne interesohemi për klientët dhe jemi të devotshëm ndaj klientëve. Ne kemi predispozitën ti njohim ata nga afër, të kuptojmë nevojat e tyre dhe ti frymëzojmë ata. Si një grup solid ne gjithmonë përpiqemi që të mbështesim dhe motivojmë kolegët tanë.

## Ne formësojmë

Ne zhvillohemi vazhdimisht. Jemi aktivë, të hapur për ide të reja dhe për të implementuar standarte të reja në sektorin e sigurimeve me zgjidhje të reja inteligjente. Si skuadër ne i zhvillojmë fuqitë tona dhe jemi gjithmonë të gatshëm për të mësuar dhe për tu rritur profesionalisht.

## Ne jemi të hapur

Ne jemi të ndershëm dhe të drejtpërdrejtë. Veprimet tona brenda kompanisë si dhe me palët e tjera janë të hapura dhe transparente. Ne u besojmë klientëve tanë dhe kolegëve, ndaj dhe shërbimi që ofrojmë është i besueshëm.  Nuk ka asnjë axhendë të fshehur, gjithçka është transparente.

## Ne servirim

Ne duam të jemi të suksesshëm. Si SIGAL UNIQA, qëllimi ynë kryesor është që të jemi gjithmonë të parët, gjithmonë lider të tregut. Ne jemi të suksesshëm sepse u ofrojmë klientëve tanë shërbimin më të mirë dhe të pakrahasueshëm. Ne gjithmonë i mbajmë premtimet ndaj klientëve dhe ndaj njëri-tjetrit.



# Bordi Mbikëqyrës SIGAL UNIQA Group Austria



**Andreas Brandstetter**
Kryetar i Bordit Mbikqyrës, SIGAL UNIQA
CEO i UNIQA Insurance Group



**Erhard Busek**
Zv. Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



**Wolfgang Kindl**
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA
CEO i UNIQA International



**Gerald Mueller**
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



**Alexander Breit**
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



**Vinzenz Benedikt**
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



**Martin MATA**
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



# NGJARJE TË RËNDËSISHME




## Sponsor zyrtar i Kombëtares Shqiptare të Futbollit

Më 28 prill 2016 SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA nënshkroi marrëveshjen e sponsorizimit me Federatën Shqiptare të Futbollit duke u bërë kështu sponsor zyrtar i Kombëtareës Shqiptare të Futbollit. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në praninë e mediave, Z. Ponari u shpreh: “Ndër vite ne kemi mbështetur disiplina të ndryshme të sportit në tërësi, duke filluar me futbollin, basketbollin, athletikën, alpinizmin, aeronautikën etj, por të mbështesësh Kombëtaren Shqiptare është krejt tjetër gjë. Djemtë e kombëtares janë krenaria jonë kombëtare, janë ambasadorët tanë më të mirë nëpër botë dhe ne jemi të lumtur që i mbështesim ata. Talentët kuq e zi na plotësuan ëndrrën europiane duke na kualifikuar në Euro 2016, ndaj ne ua kishim ‘borxh’ këtë suport. Me kontratën e firmosur sot me Presidentin Duka, kompania që unë drejtoj, SIGAL UNIQA angazhohet të ofrojë mbështetjen e saj për Kombëtaren Shqiptare”.

Më tej, Z. Ponari u bëri thirrje edhe kompanive të tjera që ta mbështesin sportin e në mënyrë të veçantë vuri theksin tek politikat lehtësuese fiskale që duhet të ndërmarrë shteti ndaj sportit.

“Mund ta them me plot gojën që SIGAL ka dëshmuar se mbetet jo vetëm kompania lider në sigurime, por edhe kompania lider në mbështetjen dhe zhvillimin e sportit në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Unë do t’i ftoja të gjitha kompanitë e tjera, të gjitha bizneset në vend që ta mbështesin sportin, pasi aty është e ardhmja e rinisë, e ardhmja e talenteve shqiptare, të cilët duhen ndihmuar e promovuar. Nga ana tjetër, duhet që edhe shteti të luajë rolin e tij nëpërmjet politikave fiskale lehtësuese, në mënyrë që sporti në

Shqipëri të marrë vendin që i takon dhe Shqipëria të garojë denjësisht në arenat ndërkombëtare. Djemtë tanë kanë bërë më të mirën e tyre, tani është radha jonë që të bëjmë detyrën tonë morale, është radha e shtetit të bëjë detyrën e tij, në mënyrë që t'i ndihmojmë talentet shqiptare të korrin sa më shumë suksese", -tha Ponari gjatë ceremonisë së firmosjes së kontratës.

Krahas sponsorizimit, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka marrë kështu nën mbrojtje djemtë e kombëtares duke i siguruar ata. Pjesë e kontratës, nga e cila do të përfitojnë sigurimin e shëndetit, janë edhe të gjitha ekipet e grupmoshave, të gjitha ekipet e Superligës Shqiptare si dhe i gjithë stafi i FSHF-së.

"Me këtë kontratë, ne zotohemi të marrim nën mbrojtje, duke siguruar rreth 500 lojtarë të të gjithë Federatës Shqiptare të Futbollit si dhe stafin drejtues të Federatës. Është hera e parë që sigurohet Federata Shqiptare e Futbollit dhe jemi krenarë që talentet shqiptare, përfshirë edhe kombëtaren, na u besuan ne", -shtoi më tej Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA.
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, përveç detyrimeve kontraktuale me klientët e saj, ka qenë gjithmonë partnere e sportit, arsimit, artit e trashëgimisë kulturore në Shqipëri, duke mbështetur financiarisht aktivitete të ndryshme.




## SIGAL UNIQA KOSOVA vlerësohet me Medaljen e Mirënjohjes në 13-vjetorin e saj

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosova festoi këtë vit 13-vjetorin e themelimit të saj. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast morën pjesë personalitete të larta të politikës dhe financave kosovare ndër të cilët Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, Znj. Hykmete BAJRAMI, Ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Z. Arsim BAJRAMI, Zëvendës-Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës Z. Fehmi MEHMETI, si dhe përfaqësuesë të tjerë të institucioneve shtetërore të shtetit të Kosovës.
Në fjalën e tij, CEO i SIGAL UNIQA, Z. Avni PONARI, vuri theksin në kontributin e kompanisë në ekonominë e Kosovës, sikundër u shpreh se ndjehet krenar që jemi në Republikën së Kosovës.

"SIGAL u vendos këtu në periudhën e rëndësishme historike, kur Kosova e dalë nga lufta po ndërtonte institucionet e veta demokratike, zhvillonte ekonominë dhe biznesin e rrënuar dhe po rendte drejt shpalljes së pavarësisë. Sot pas kaq vitesh, kjo kompani krenohet që në logon e saj vendoset emri Republika e Kosovës dhe beson se ka bërë më të mirën e mundshme për të ndihmuar në zhvillimin e ekonomisë së kësaj Republike. SIGAL UNIQA numëron sot mbi 60 zyra në të gjithë Kosovën dhe mbi 250 punonjës e agjentë. Pas 13 vitesh SIGAL UNIQA është krenare që solli në Kosovë investitorin strategjik të sigurimeve, UNIQA GROUP, duke i siguruar Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë garancinë e tregut të sigurimeve."

Ministrja Bajrami, në emër edhe të Kryeministrit të Kosovës, Z. Isa Mustafa, falënderoi kompaninë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA për kontributin e dhënë në ekonominë e vendit dhe shprehu gadishmërinë e qeverisë për krijimin e një ambjenti makro-fiskal stabël dhe theksoi se do të dëgjojnë dhe përparësi këshillat dhe nevojat e biznesit për përmirësimin e tregut të sigurimeve në veçanti dhe të të bërit biznes në tërësi.

Në këtë event, Aleanca Kosovare e Bizneseve, në shenjë falënderimi për punën shumë të mirë të SIGAL UNIQA dhe për kontributin e dhënë përgjatë 13 viteve në Kosovë, i dorëzoi Drejtorit të Përgjithshëm të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, z. PONARI "Medaljen e Mirënjohjes".





## Takimi vjetor 2016

Grupi rajonal SIGAL UNIQA zhvilloi takimin vjetor 2016 në Strugë në të cilën morën pjesë drejtues të lartë dhe menaxherë të kompanive SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Gjatë takimit u analizuan arritjet e SIGAL UNIQA si dhe sfidat me të cilat u përballëm gjaë 2016.
Synimi i takimeve rajonale të SIGAL UNIQA është gjetja e zgjidhjeve për çështjet kryesore të Kompanisë duke analizuar gjendjen e saj dhe tendencat e secilit prej tregjeve ku operon SIGAL UNIQA.




**Bordi i Drejtorëve**
**Shqipëri, Kosovë, Maqedoni**



## Vlerësime ndërkombëtare

Gjatë vitit 2016, SIGAL UNIQA u rendit sërish si një ndër kompanitë më të mira në sigurimit në rajonin e Europës Qendrore dhe Lindore. South East European Neës analizon performancën e bizneseve, ndër të cilat banka dhe kompani sigurimi të cilat operojnë në këtë rajon dhe mbi këtë bazë publikon listën e bizneseve me treguesit më të mirë. SIGAL UNIQA është kompania e vetme e sigurimeve në Shqipëri e cila u përfshi në listën e kompanive me përformancën më të mirë.

Një vlerësim i ri për këtë vit erdhi nga Superbrands i cili cilësoi SIGAL UNIQA si një prej kompanive me shërbimin më cilësor në Shqipëri.

Vlerësime dhe çmime të ndryshme I janë akorduar SIGAL UNIQA pas një analize të detajuar që insitucione të ndryshme i bëjnë tregut shqiptar të sigurimeve dhe atij rajonal bazuar në performancën e secilës prej kompanive që operojnë në këtë treg. SIGAL UNIQA vlerësohet në vijimësi, ndër të tjera, për shërbimin cilësor ndaj klientit, lidershipin, risitë që sjell dhe prestigjin.

Ndër këto çmime rendisim "European Awards for best Practices 2016"; "Best Insurance Company-Southeast Europe 2016"; "The Winner Awards Trophy"; "Best Enterprise"; "Best Insurance Company Albania"; "Best Buy Award"; "TOP 100 Insurance companies in CEE"; "Golden Europe Award for Quality & Commercial Prestige"; "Best insurance company for the best quality in the market".

TOP 100

*Ranked among the Best Performing Insurance Companies in Southeast Europe*

Superbrand of Albania (2015-2016)

Raporti më i Mirë Çmim - Cilësi 2015-2016
nga Best Buy Award

Best Insurance Company in Albania 2016
by Global Banking & Finance Review

**UNIQA Group 2016**

9.6 milionë klientë

378,000 përdorues të myUNIQA në Austri

Operon në 18 shtete

€5 bilionë prime

18.8 milionë kontrata sigurimi

21.3% e tregut të sigurimeve në Austri

€3.5 bilionë dëme të paguara

1,632 punonjës të rinj

**SIGAL UNIQA 2016**

1139 punonjës

737 mijë kontrata sigurimi

€31 milionë kapitali

10,251 ndjekës në SIGAL UNIQA Facebook

401 zyra

€57.7 milionë prime



# PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Zhvillimi ekonomik i një kompanie nuk mund të konceptohet nëse nuk shoqërohet me një përgjegjësi të lartë sociale. Për këtë arsye, SIGAL UNIQA ka mbështetur edhe gjatë vitit 2016 një sërë projektesh në fushën sociale, kulturore dhe sportive.




## Sociale

Si një kompani që provon kujdesin shëndetësor, SIGAL UNIQA vijoi edhe gjatë 2016-ës ofrimin e ekzaminimeve falas shëndetësore përmes të vetmes klinikë lëvizëse në rajon SIGAL UNIQA VitalTruck. Klinika, e cila u prezantua për herë të parë në vitin 2015, vijoi turin e saj për të ofruar ekzaminime mjekësore për qindra banorë në Valbonë, Vermosh, Selcë, Berat, Shkodër, Sarandë dhe fshatrat përreth. Si sponsor të maratonës Run4Autism synimi i së cilës ishtë ndihma për fëmijët autikë, iu ofruam të gjtihë pjesëmarrësve në garë kontrolle dhe asistencë të menjëhershme mjekësore gjatë maratonës.



## Kulturë

Ne mendojmë se investimi në projekte kulturore është ndër investimet më të mira që mund të bëjmë për të ardhmen. Gjatë vitit 2016 kemi mbështetur një sërë projektesh kulturore si Festivali i Filmit per te Drejtat e Autorit; Ekspozitën e artistit autriak Peter Kogler' Festivalin Ndërkombëtar të Muzikës Operistike






'Marie Kraja'; Instalacionin 'Reja' të muzeut britanik të arteve'.

Orkestra e Harqeve e Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA vijoi edhe gjatë 2016-ës performancën e saj përmes disa koncerteve të muzikës së dhomës ndër të cilat veçojmë ojesëmarrjen në Takimin Kombëtar të Orkestrave të Harqeve të Muzikës së Dhomës në të cilin u vlerësua maksimalisht nga ekspertë dhe art-dashës të muzikës.

### Sport

Edhe gjatë 2016-ës treguam se besojmë fort tek shëndeti i mirë përmes aktivitetit sportiv. Në këtë kuadër, vijuam suportin tonë për Federatën Shqiptare të Basketbollit dhe Ligën Ballkanike të Basketbollit. Gjithashtu, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, mbështetëm ndërtimin e një fushë sportive në Tiranë në të cilën qindra të rinj zhvillojnë aktivitete të ndryshme në sporte si futbolli, basketbolli dhe volejbolli.

Skuadra rajonale e futbollit SIGAL UNIQA mori pjesë këtë vit në kampionatit europian të futbollit UNIQA EM i cili zhvillohet çdo dy vjet në Austri me pjesëmarrjen e ekipeve të kompanive UNIQA nga 19 shtete.










## Sigurimi online tashmë një realitet

Për herë të parë në Shqipëri, SIGAL UNIQA mundësoi platformën elektronike për sigurimin online. Përmes sitit www.sales.sigal.com. al çdokush mund të blejë brenda pak minutash sigurimin e makinës, shëndetit në udhëtim apo aksidenteve kudo ku ndodhet. Në rastin e sigurimeve të dëtyrueshme sipas ligjit shqiptar, SIGAL UNIQA dërgon policën e sigurimit në adresën e klientit, brenda ose jashtë Shqipërisë. Ndërkohë, për sigurimet vullnetare të shëndetit në udhëtim, sigurimin për nxënës dhe studentë dhe sigurimin e aksidenteve, është e vlefshme kopja elektronike e policës.

Në këtë mënyrë, SIGAL UNIQA është një hap përpara në ofrimin e shërbimeve novatore për klientët e saj përmes këtij kanali shitjeje i cili është i disponueshëm në çdo moment, çdo ditë.

Përmes ofrimit të sigurimit online, SIGAL UNIQA është gjithashtu në linjë me strategjinë e UNIQA Insurance Group e cila ka në qëndër të strategjisë së saj që prej 2011, inovacionin dhe shërbimet online.



Në këtë kuadër, UNIQA ka planifikuar një buxhet prej 500 milionë euro në sajë të të cilave do të gjenerohen sisteme të reja IT brenda vitit 2020.



# TREGU I SIGURIMEVE NË RAJON

**Tregu shqiptar i sigurimeve jo-jetë**

Tregu i sigurimeve të jo-jetës, në të cilin operojnë 8 kompani, u udhëhoq nga SIGAL UNIQA e cila zotëroi 27.41% të tregut.

SIGAL UNIQA renditet gjithashtu e para edhe për pagesën e dëmeve duke paguar 23.21% të dëmeve.




**Tregu shqiptar i sigurimeve të jetës**

Që prej disa vjetësh, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani sigurimi. Edhe për vitin 2016 tregu u udhëhoq nga SIGAL Life UNIQA me 59.96% e cila ka paguar 49.7% të dëmeve të ndodhura në treg.




**Tregu shqiptar i pensioneve private**

Gjatë vitit 2016, në tregun e pensioneve operuan 3 fonde pensionesh private. Fondi i Pensioneve SIGAL udhëhoqi tregun si për vlerën e aseteve neto (51%) ashtu edhe për numrin e kuotave.






**Tregu kosovar i sigurimeve**

Në tregun kosovar operojnë 12 kompani sigurimi ndër të cilat SIGAL UNIQA Kosova renditet e para me 15.86% të tregut për volumin e primeve si dhe ka paguar 17.29% të dëmeve totale të tregut.




Në tregun kosovar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani ndër të cilat SIGAL Life UNIQA Kosova renditet e dyta me 33.46% të tregut për volumin e primeve dhe ka paguar 19.79 % të dëmeve.




**Tregu maqedonas i sigurimeve**

Në tregun maqedonas të sigurimeve të jo-jetës operojnë 11 kompani. UNIQA a.d. u rendit në vendin e gjashtë për nga volumi i primeve të shkruara (9.38%).




UNIQA Life renditet e katërta në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës (5.65 %) në të cilin operojnë 4 kompani.



# TË DHËNA FINANCIARE

## Grupi SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA
Prime të shkruara për katër vitet e fundit (në euro)




| Kompania | 2013 (në Euro) | 2014 (në Euro) | 2015 (në Euro) | 2016 (në Euro) |
|---|---|---|---|---|
| SIGAL UNIQA AL Jo-Jetë dhe Risigurime | 18,920,508 | 21,976,027 | 26,826,453 | 29,193,000 |
| SIGAL Life UNIQA AL | 4,136,826 | 4,724,770 | 4,821,793 | 4,249 ,000 |
| SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA | 1,442,152 | 788,946 | 1,269,642 | 1,681 ,000 |
| SIGAL UNIQA KS Jo-Jetë | 10,912,741 | 12,390,804 | 12,482,576 | 10,501,000 |
| SIGAL Life UNIQA KS | 238,858 | 338,738 | 910,595 | 762 ,000 |
| UNIQA MK Jo-Jetë | 10,371,295 | 10,216,259 | 11,063,068 | 11,323 ,000 |
| UNIQA Life MK | 669,719 | 760,249 | 961,656 | 1,170 ,000 |
| GRUPI | 46,692,100 | 51,195,794 | 58,335,782 | 58,879 ,000 |

## Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2016




| Lloji i Produktit | AL (në Euro) | KS (në Euro) | MK (në Euro) | Grupi (në Euro) |
|---|---|---|---|---|
| Pasuri | 9,686,274 | 1,784,990 | 2,709,769 | 14,181,033 |
| Motorike | 16,221,066 | 6,149,059 | 6,120,109 | 28,490,234 |
| Jetë, Shëndet dhe Aksidente | 6,927,615 | 3,328,476 | 3,663,002 | 13,919,093 |
| Pensione Vullnetare* | 1,681,232 | - | - | 1,681,232 |
| Risigurime* | 606,967 | - | - | 606,967 |
| TOTALI | 35,123,153 | 11,262,525 | 12,492,880 | 58,878,558 |

** Produktet e Pensioneve vullnetare dhe Risigurimet ofrohen vetëm në Shqipëri përkatësisht nga kompanitë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime dhe SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA.*

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

Pasqyrat Financiare te Konsoliduara sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 (me raportin e audituesit bashkëlidhur)

# *Raporti i Audituesit të Pavarur*

Drejtuar Aksionerit dhe Drejtimit të Sigal Uniqa Group Austria sh.a

## *Opinioni ynë*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Sigal Uniqa Group Austria sh.a dhe entiteteve të tij ("Grupi") më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

**Ne kemi audituar:**

Pasqyrat e financiare të konsoliduara të Grupit përfshijnë:

- pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016;
- pasqyra e konsoliduar e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e konsoliduar e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

## *Baza për opinionin*

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

**Pavarësia**

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

## *Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara*

Drejtimi i Grupit, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat Drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, Drejtimi i Grupit është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

*PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Rr. Ibrahim Rugova, SkyTower, kati 9, Tiranë, Shqipëri*
*T: +355 (4) 2242 254, F:+355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al*

Regjistruar në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit më 15 korrik 2009 dhe me Numër Identifikimi NUIS K91915023A

## *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara*

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare të konsoliduara, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Drejtimi.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Grupit.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Grupit, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k
Tiranë, Shqipëri
22 qershor 2017

Auditues ligjor
Jonid Lamllari

**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**
**Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016**
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

| | Shënime | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVET** | | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre | 10 | 337,711 | 468,977 |
| Depozita me afat | 11 | 7,366,431 | 6,508,551 |
| Investime në letra me vlerë; | 12 | 1,813,417 | 1,852,479 |
| Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të arkëtueshme të tjera | 13 | 1,053,813 | 1,080,616 |
| Aktive të risigurimit | 14 | 1,263,993 | 715,354 |
| Kostot e shtyra të marrjes në sigurim | 15 | 942,392 | 881,432 |
| Aktive afatgjata materiale | 16 | 1,259,676 | 1,346,866 |
| Aktive të tjera | 17 | 343,010 | 258,389 |
| **TOTALI AKTIVEVE** | | **14,380,443** | **13,112,664** |
| **DETYRIMET** | | | |
| Rezerva teknike të dëmeve dhe shpenzime për rregullimin e humbjes | 18 | 4,424,623 | 3,653,407 |
| Rezerva për primet e pafituara | 18 | 3,854,879 | 3,794,703 |
| Rezerva të tjera | 18 | 1,005,268 | 853,163 |
| Detyrime të tatimit mbi fitimin | | 14,363 | 29,399 |
| Detyrime nga sigurimet dhe risigurimet | 19 | 590,398 | 481,762 |
| Detyrime të tjera | 20 | 252,489 | 287,045 |
| **TOTAL I DETYRIMEVE** | | **10,142,020** | **9,099,479** |
| **KAPITALI** | | | |
| Kapitali themeltar | 21 | 2,232,909 | 2,232,909 |
| Rezerva të tjera të kapitalit | 22 | 52,133 | 52,133 |
| Rezerva të rrezikut të sigurimit | 22 | 568,313 | 545,761 |
| Rezerva të konvertimit | | 32,294 | 51,878 |
| Fitime të mbartura | | 1,342,372 | 1,121,791 |
| **Totali i kapitalit që i atribuohet pronarëve të shoqërisë mëmë** | | **4,228,021** | **4,004,472** |
| **Interesi jo-kontrollues** | | **10,402** | **8,713** |
| **TOTALI KAPITALIT** | | **4,238,423** | **4,013,185** |
| **TOTALI KAPITALIT DHE DETYRIMEVE** | | **14,380,443** | **13,112,664** |

Shënimet nga faqja 5 në 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë aprovuar nga drejtuesit e grupit më 31 maj 2017 dhe janë firmosur nga:

Avni Ponari
Drejtor i Përgjithshëm

Klement Mersini
Drejtor Finance

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA
DREJTORIA E PERGJITHSHME
HEAD OFFICE



